



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronjat b) dhe i) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.9, të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafët 3.1 dhe 3.2 të Rregullores Komunale për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot. 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, merr;

VENDIM

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE ME GJENDJE TË RËNDË SHËNDETËSORE DHE SOCIALE

Neni 1

Me këtë vendim lejohet dhënia e ndihmës financiare në shumë të përgjithshme prej 14,650.00€, ndihmë për tetëdhjetetë (83) persona me gjendje të rëndë shëndetësore dhe ekonomike - sociale për muajin prill 2025, sipas shumave individuale të paraqitura në listën e rekomanduar nga komisioni përkatës.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 3

Shuma e mjeteve individuale sipas listës bashkangjitur këtij vendimi nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022.

Neni 4

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

Neni 5

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot 02-400/04-0024746/25
Podujevë, datë 06.05.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Buliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 9 të Rregullores MF - Nr – 04/2017 Mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, të, nxjerr:

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE TË OJQ- ve

Neni 1

Themelohet Komisioni i ankesave në kuadër të Administratës komunale për shqyrtimin e ankesave të OJQ-ve në procesin e financimit publik në këtë përbërje:

znj.Lumturie Gashi, zyrtare ligjore 2 - Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë – kryesuese.

z.Avni Maloku, zyrtar për çështje pedagogjike – Drejtoria e Arsimit – anëtar.

znj.Naxhije Hasani, zyrtare për invalid të luftës dhe familjeve të dëshmorëve – Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – anëtare.

znj.Hamide Aliu Selmani, zyrtare për bujqësi – Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, caktohet anëtare rezervë, e cila zëvendëson anëtarin/en e Komisionit në rast të paraqitjes së konfliktit të interesit.

Neni 2

Komisioni, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me Rregulloren mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3

Komisioni ka mandat dy vjeçar.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Anëtarëve të Komisionit
Drejtorive përkatëse
QSHQ/Arkivit
Zyrës së Personelit

Nr. Prot. 02-020/04-0025555/25
Podujevë, datë, 08.05.2015

Kryetari i Komunës
Shpëtim Buliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 dhe 3.2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.06-400/04-0024401/25 të datës 05.05.2025, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z.Skender Xhaka, nga fshati Miroc, Komuna e Podujevës për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve mjekësore i jepet ndihmë financiare në shumë 500.00€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

z.Skender Xhaka (njoftohet përmes DSHMS-së).

Nr.prot. 02-400/04-00255 97/25
Podujevë, datë, 12.05.2025





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, jep këtë :

A U T O R I Z I M

Autorizohet z.Bahri Selimi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit në Komunën e Podujevës, të veprojë dhe të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetenca dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Drejtorisë Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, derisa z. Liridon Gashi, Drejtor i Drejtorisë së cekur të kthehet nga pushimi, apo eventualisht deri në nxjerrjen e një akti tjetër.

Ky Autorizim vlen nga data 13.05.2025.

Me këtë njoftohen:

I autorizuari

Qendra e Shërbimit për Qytetarë

Zyra e Personelit

Nr.Prot. 02-016/01-0026403/25
Podujevë, datë: 13.05.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 17 (f) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040 , neneve 16 dhe 19 paragrafi 1.6 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18 dhe nenit 31.2 të Rregullores për Shërbime Publike Komunale nr. 01/155-352, Kryetari i Komunës së Podujevës, nxjerrë :

URDHËRESË PËR MËNYRËN E PËRDORIMIT TË UJIT PËR PIJE NGA RRJETI I UJËSJELLËSIT NË SEZONIN VEROR

Neni 1

Në territorin e Komunës së Podujevës, në sezonin veror, caktohet mënyra dhe kufizimi i përdorimit të ujit për pije nga rrjeti i ujësjellësit.

Neni 2

1.Në sezonin veror, prej datës 14.05.2025 deri më 15.10.2025 ndalohet shfrytëzimi i ujit nga rrjeti i ujësjellësit, për:

- 1.1. Larjen e automjeteve, rrugëve, trotuareve dhe vendeve publike
- 1.2. Ujitjen e kopshteve, fushave me barë, pemëve apo ndonjë fushe të agrikulturës.
- 1.3. Për subjektet afariste të cilat ushtrojnë veprimtarinë e larjes së automjeteve.

Neni 3

Të gjithë konsumatorët e ujit janë përgjegjës të sigurojnë se pas pikës hyrëse, të gjitha pajisjet e ujit të jenë në funksion të plotë, duke përfshirë të gjitha rubinetet dhe pajisjet hidraulike brenda objekteve dhe pronave, si dhe pajisjeve që lidhen me sistemin kryesor të furnizimit me ujë për pije.

Neni 4

KUR "Prishtina"-Njësia në Podujevë do të sigurojë funksionalitetin maksimal të rrjetit të ujësjellësit të ujit për pije, gjithashtu është e obliguar të përgjigjet menjëherë pa asnjë vonesë, në çdo raportim të ndonjë defekti në sistemin e rrjetit të ujësjellësit dhe të bëjë riparimin në afatin sa më të shkurtër.

Neni 5

Zbatimin e Urdhresës e bëjnë Drejtoria e Inspeksionit dhe KUR "Prishtina"- Njësia në Podujevë.

Neni 6

1. Mosrespektimi i Nenit 2 paragrafi 1.1 konsiderohet kundërvajtje dhe ndëshkohet me gjobë mandatore në shumë prej.....100,00 €.
2. Mosrespektimi i Nenit 2 paragrafi 1.2 dhe 1.3 konsiderohet kundërvajtje dhe ndëshkohet me gjobë në shumë prej.....300.00 €
3. Nëse ndëshkimet e shqiptuara mandatore nuk përmbushen në afat prej 15 ditësh, inspeksioni do të ndërmarr veprimet përkatëse ligjore.

Neni 7

Urdhëresa hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot. 02-352/06-0026592/25

Podujevë, Datë: 14.05.2025





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 15 paragrafi 1.8 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.02-400/04-0025399/25 të datës 08.05.2025, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

znj.Shyhrete Restelica, nga Podujeva, për mbulimin e shpenzimeve të vajzës së saj Alea Restelica, për pjesëmarrjen në garat evropiane të sigurisë kibernetike në Varshavë të Polonisë, mbështetet me mjete financiare në shumë 400.00€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Arsimit dhe të njëjtat barten përmes bankës në llogarinë e të përmendurës e cila ka për obligim që pas përfundimit të garave që mbahen në Varshavë të Polonisë të ofroj dëshmi për vajzën e saj lidhur me pjesëmarrjen dhe sukseset e regjistruara në këtë garë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.


znj.Shyhrete Restelica (njoftohet përmes DKA-së).

Nr.prot 02-400/04-0026667/25
Podujevë, datë, 15.05.2025





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 15 paragrafi 1.8 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.02-400/04-0025397/25 të datës 08.05.2025, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

znj.Diella Kika, nga Podujeva, për mbulimin e shpenzimeve për pjesëmarrjen në garat evropiane të sigurisë kibernetike në Varshavë të Polonisë, mbështetet me mjete financiare në shumë 400.00€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Arsimit dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurës e cila ka për obligim që pas përfundimit të garave që mbahen në Varshavë të Polonisë të ofroj dëshmi lidhur me pjesëmarrjen dhe sukseset e treguara në këtë garë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

znj.Diella Kika (njoftohet përmes DKA-së).

Nr.prot 02-400/04-0026671/25
Podujevë, datë, 15.05.2025





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, jep këtë :

A U T O R I Z I M

Autorizohet znj.Valbona Ibishi Azemi, Drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës në Komunën e Podujevës, të veprojë dhe të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetenca dhe përgjegjësitë e Drejtoreshës të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, derisa znj.Lirie Hoti, Drejtoreshë e Drejtorisë së cekur të kthehet nga pushimi vjetor, apo eventualisht deri në nxjerrjen e një akti tjetër.

Ky Autorizim vlen nga data 16.05.2025 deri më 23.05.2025

Me këtë njoftohen:

E autorizuara

Qendra e Shërbimit për Qytetarë

Zyra e Personelit

Nr.Prot.02-020101-0027112/25
Podujevë, datë: 16.05.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot.01-02/01-0050862/18, nenet 3.3; 11.1 dhe 22 të Rregullores (komunale) për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-401/01-0065086/24, të datës 26.09.2024, për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore 2026-2027, në implementim të projektit "Furnizim me pajisje për bletë" sipas Ftesë Publike nr.prot.12-320/01-0015320/25 të datës 17.03.2025, në Rekomandim të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0019969/25 të datës 08.04.2025, për shqyrtimin edhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, merr:

V E N D I M

Neni 1

1. Lejohen mjete financiare në shumë totale 28,571.00€, nga e cila 19,999.70€ apo 70% e vlerës financim nga Komuna e Podujevës, kurse pjesa tjetër prej 8,571.30€ apo 30% e vlerës së projektit është participimit nga ana e fermerëve përfitues në projektin e Komunës "Furnizim me pajisje për bletë", përkatësisht për 15 fermer përfitues.

2. Mbështetja e fermerëve sipas këtij vendimi bëhet konform kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Ftesën publike përkatëse për aplikim në projektin "Furnizim me pajisje për bletë".

Neni 2

Qëllim i realizimit të këtij projekti është promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista përfundimtare e fermerëve të përzgjedhur për implementimin e projektit "Furnizim me pajisje për bletë", sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e Vendimit kujdeset Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave si dhe Komisionin përkatës sa i përket verifikimit, konstatimit dhe vlerësimit të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve nga ana e fermerit/es si dhe çështjeve tjera të parapara në Ftesën publike përkatëse.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. Prot. 02400/03-0027477/25
Podujevë, datë, 19.05.2025

Kryetari Komunes
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, në pajtim me Rregulloren MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenit 61 parag. 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, në Rekomandim të Komisionit vlerësues për shqyrtimin e aplikacioneve për financim publik të ojQ-ve në Komunën e Podujevës për organizimin e aktiviteteve sportive, sipas Thirrjes publike datë 11.03.2025, merr:

V E N D I M **PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË KLUBEVE DHE SHOQATAVE** **SPORTIVE PËR ORGANIZIMIN E AKTIVITETEVE SPORTIVE NË** **KOMUNËN E PODUJEVËS**

Neni 1

Për financim publik të Klubeve dhe Shoqatave sportive, për realizimin e aktiviteteve sportive në Komunën e Podujevës, sipas Thirrjes publike datë 11.03.2025 dhe Rekomandimit të Komisionit vlerësues datë 20.05.2025, ndahen mjete financiare në shumë të përgjithshme **60.000 €**.

Neni 2

Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit për kushtet dhe mënyrën e realizimit të aktiviteteve sportive dhe për mënyrën e financimit publik, me secilin përfitues të mbështetjes financiare lidhë kontratë me shkrim në përputhje me Rregulloren mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 3

Lista përfundimtare e përfituesve me shumat përkatëse është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. Prot. 02-400/04-0027830/25
Podujevë, date: 21.05.2025





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, në pajtim me Rregulloren MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenit 61 parag. 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, në Rekomandim të Komisionit vlerësues për shqyrtimin e aplikacioneve për financim publik të OJQ-ve në Komunën e Podujevës për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe rinore, sipas Thirrjes publike Prot. 09-615/03-0014602/25, datë 11.03.2025, merr:

V E N D I M

PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË OJQ-ve PËR ORGANIZIMIN E AKTIVITETEVE KULTURORE DHE RINORE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për financim publik të OJQ-ve, për realizimin e aktiviteteve kulturore dhe rinore në Komunën e Podujevës, sipas Thirrjes publike nr. Prot. 09-615/03-0014602/25, datë 11.03.2025 dhe Rekomandimit të Komisionit vlerësues datë 21.05.2025, ndahen mjete financiare në shumë të përgjithshme **37,700 €**.

Neni 2

Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit për kushtet dhe mënyrën e realizimit të aktiviteteve kulturore dhe rinore dhe për mënyrën e financimit publik, me secilin përfitues të mbështetjes financiare lidhë kontratë me shkrim në përputhje me Rregulloren mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 3

Lista përfundimtare e përfituesve me shumat përkatëse është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. Prot. 02-400/03-0028022/25
Podujevë, date: 22-05-2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Buliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18, në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr.prot.02-016/01-0024690/25, të datës 05.05.2025, lidhur mes Komunës së Podujevës dhe Organizatës “Qatar Charity”, me seli në Prishtinë për ndërtimin e Parkut Bujqësor në fshatin Sfeçël të Komunës së Podujevës, merr:

V E N D I M

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR PRANIMIN E PROJEKTIT TË PARKUT BUJQËSOR NË FSHATIN SFEÇËL

Neni 1

Ngritet komisioni për pranimin e projektit të Parkut Bujqësor në fshatin Sfeçël të Komunës së Podujevës, i cili realizohet sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr.prot.02-016/01-0024690/25 të datës 05.05.2025, lidhur mes Komunës së Podujevës dhe Organizatës Qatar Charity me seli në Prishtinë, në këtë përbërje:

- | | |
|--|----------|
| - Mahmut Ajvazi , zyrtar për ndërtimtari në DSHPMSh, | kryesues |
| - Ismet Kadriu , udhëheqës i sektorit të urbanizmit në DPUMM, | anëtar |
| - Bleona Musolli , zyrtare për bujqësi në DBPZHR, | anëtare |

Neni 2

Punë dhe detyrë e komisionit sipas nenit 1 të këtij vendimi është, pranimi i projektit të hartuar konform marrëveshjes përkatëse të lidhur mes palëve të lartcekura dhe për këtë harton raport me shkrim të cilin ia paraqet Kryetarit të Komunës së bashku me projektin në fjalë.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Anëtarëve të komisionit

Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.

QSHQ/Arkivit.

Nr. Prot. 02-016/01-0029478/25
Podujevë, datë, 29.05.2025

